



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 237, datë 26.11.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN  
ENERGY SUPPLIER 2” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, si dhe nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 144/3 prot, datë 17.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1076 prot., datë 11.11.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, **plotësuar.**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërmat “a”, “c”, “d”, **plotësuar.**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika “a”, “c”, **plotësuar.**
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërma “c” (të dhëna për aplikuesin);
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata);
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit /ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë, shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).
  - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, gërma “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj); gërma “e” (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi); gërma “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve); gërma “i” (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët.)

Subjekti do të njoftohet që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, ta paraqesë atë brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**